LIGJ
Nr. 100/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT FINANCIAR USHTARAK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit financiar ushtarak ndërmjet qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2020.
Shpallur me dekretin nr. 11577, datë 3.8.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI FINANCIAR USHTARAK
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PREAMBULË

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë quhen "Pala" vetëm dhe "Palët" së bashku), me synim fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak brenda kuadrit të marrëdhënieve të qëndrueshme miqësore dhe për të kontribuar në ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kanë rënë dakord për çështjet e mëposhtme.

Neni I
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i bazës së alokimit të burimeve të alokuara, por të papërdorura prej 2,309,863.24, në dollarë amerikanë (dy milionë e treqind e nëntë mijë e tetë qind e gjashtëdhjetë e tre dollarë amerikanë e njëzet e katër cent) nga Qeveria e Republikës së Turqisë, bazuar në Marrëveshjet Ushtarake të Grandit dhe Protokollet e Aplikimeve Logjistike të specifikuara në nenin X të kësaj Marrëveshjeje për Këshillin e Ministrave të Republikës së

Shqipërisë, me qëllim që të blihen shërbime për qëllime ushtarake mundësisht nga firmat dhe shoqëritë që e kanë 100% të prodhimit të brendshëm kryesisht në Turqi.

Neni II
Objekti

Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, fondet në shumën 2,309,863.24, në dollarë amerikanë (dy milionë e treqind e nëntë mijë e tetë qind e gjashtëdhjetë e tre dollarë amerikanë e njëzet e katër cent) do të jepet në formën e kontributit financiar për koston e mallrave dhe shërbimeve që do të blihen nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë për qëllime ushtarake mundësisht nga firmat dhe shoqëritë vendëse që janë pjesë 100% e prodhimit të brendshëm kryesisht në Turqi dhe në pajtim me legjislacionin përkatës të Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Neni III
Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit

Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë në emër të Qeverisë të Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pikat e kontaktit për këtë Marrëveshje janë Zyra e Atasheut Ushtarak/Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Ankara/Republika e Turqisë dhe Zyra e Atasheut Ushtarak e Republikës së Turqisë në Tiranë/Republika e Shqipërisë.

Neni IV
Parimet e zbatimit

1. Në rastin e blerjes së materialeve dhe të shërbimeve, për qëllime ushtarake nga firmat dhe institucionet e brendshme, kryesisht në Turqi dhe mundësisht të jenë pjesë 100% e prodhimit të brendshëm, fondet e alokuara në shumën 2,309,863.24 në dollarë amerikanë (dy milionë e treqind e nëntë mijë e tetë qind e gjashtëdhjetë e tre dollarë amerikanë e njëzet e katër cent) burimet ofrohen për përdorim nën koordinimin e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje.
2. E drejta e disponimit të fondeve të alokuara por të papërdorura i takojnë Republikës së Turqisë.
3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dërgon letrën e kërkesave (në një mënyrë që të mbulojë edhe prioritetet e tij), për t'u përcaktuar, duke konsideruar fondet e alokuara për procesin e prokurimit Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në kuadrin e parimeve që do të specifikohen nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë, fillon procesi i prokurimit nga firmat dhe institucionet prioritare në Turqi, mundësisht që janë pjesë 100% e produktit të brendshëm.
4. Furnitori i dërgon mallrat që do të dorëzohen në Republikën e Shqipërisë nga Turqia në vendin përkatës dhe nuk kryhet tregtim tranzit.
5 Dërgesa, ngarkesa, transporti, ngarkimi, paketimi, shpenzimet e trajnimit dhe shpenzimet e transportit, ushqimit dhe akomodimit të personelit që vijnë në Turqi për përmbushjen e këtij trajnimi, shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me alokimin e fondeve me para në dorë, si: dietat e udhëtimeve dhe pagesat ditore, sigurimet, tarifat bankare, tatimet, tarifat dhe shpenzimet për diferencat në kursin e këmbimit rregullohen në kontratën e shitjes që lidhet ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Republikës së Shqipërisë dhe firmës.
6. Pagesat bëhen pas njoftimit të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me një notë nëpërmjet kanaleve diplomatike që mallrat janë marrë tërësisht dhe të padëmtuara, në pajtim me termat e kontratës dhe

procedurat e inspektimit, sipas kërkesave të procesit të prokurimit të kryera nën koordinimin e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë.

7. Në rastin kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bën një blerje tej shumës së fondeve të alokuara, ai duhet të transferojë fondet shtesë tej shumës së alokuar. Qeveria e Republikës së Turqisë nuk bën asnjë pagesë tej shumës së njoftuar të alokuar. Fondet shtesë paguhen nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

8. Vizitat në lidhje me procesin e prokurimit fillohen pas njoftimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shumën e alokuar. Shpenzimet e punonjësve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me këtë proces, mbulohen nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Pas tranzitimit të mallrave dhe të shërbimeve të prokuruara në Shqipëri, zbatohen ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni V
Të drejtat e përdorimit për mallrat dhe shërbimet

1. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, fondet e transferuara dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Turqisë nuk mund të përjashtohen nga inventari nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, pa pëlqimin me shkrim të Qeverisë së Republikës së Turqisë.

2. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë nuk transferon mallra dhe shërbime ose përdorimin e tyre te një vend i tretë ose palë e tretë, pa pasur paraprakisht pëlqimin me shkrim të Qeverisë së Republikës së Turqisë.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikojnë angazhimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, ku të dy vendet janë palë dhe nuk përdoren kundër interesave, sigurisë dhe integritetit territorial të shteteve të tjera.

Neni VI
Siguria e informacionit të klasifikuar

Palët nuk deklarojnë përmbajtjen dhe zbatimin e Marrëveshjes ose informacionit të klasifikuar që do të shkëmbehet ndërmjet Palëve një pale të tretë, pa pëlqimin më shkrim të Palës tjetër. Ky parim konfidencialiteti vazhdon të zbatohet edhe pas pushimit të fuqisë së Marrëveshjes.

Neni VII
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë, për shkak të zbatimit ose interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, zgjidhet nëpërmjet negociatave nëpërmjet kanaleve diplomatike, pa iu paraqitur një pale të tretë, bordi arbitrazhi apo gjykate ndërkombëtare dhe zgjidhet nëpërmjet bisedimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike. Nëse nuk arrihet një zgjidhje si rezultat i bisedimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike, kjo Marrëveshje mund të prishet sipas procedurës së përcaktuar në nenin X.

Neni VIII
Rishikimi dhe ndryshimi

1. Secila Palë mund të propozojë rishikimin ose ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast, Palët fillojnë diskutimet, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim për këtë.

2. Ndryshimet e rëna dakord nga Palë me shkrim hyjnë në fuqi në pajtim me procedurën e përshkruar në nenin IX.

3. Nëse nuk arrihen rezultate brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve në diskutime, kjo Marrëveshje mund të prishet sipas dispozitës së nenit X.

4. Palët vazhdojnë të përmbushin detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo Marrëveshje gjatë procesit të negociatave.

Neni IX

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët, nëpërmjet kanaleve diplomatike, njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore që kërkohen për hyrjen e kësaj Marrëveshjeje në fuqi.

Neni X

Kohëzgjatja dhe pushimi i fuqisë

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi.

2. Në rastin kur një prej Palëve nuk respekton ose nxjerr përfundimin që Pala tjetër nuk respekton dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të jenë në gjendje të propozojnë një konsultim me shkrim. Këto konsultime fillojnë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pasi të jetë marrë njoftimi me shkrim. Nëse nuk është arritur asnjë rezultat, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, secila palë e prish këtë Marrëveshje, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

3. Në çdo rast, nëse fondet e alokuara Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në pajtim me këtë Marrëveshje janë përdorur tërësisht, marrëveshja pushon automatikisht.

4. Nëse Marrëveshja pushon për një arsye të caktuar, fondet e alokuara por të papërdorura i kthehen thesarit të Republikës së Turqisë, pa marrë parasysh datën e njoftimit të fondeve të papërdorura.

5. Pushimi i fuqisë së Marrëveshjes, për çfarëdolloj shkaku nuk cenon dispozitat e nenit V të kësaj Marrëveshjeje.

6. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, prishen 26 (njëzet e gjashtë) marrëveshjet dhe protokollet e renditura më poshtë:

a) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 10 korrik 1998;

b) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 1 tetor 1998;

c) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 21 qershor 1999;

d) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 18 korrik 1999;

e) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i përgatitur bazuar në Marrëveshjet Ushtarake të Grandit të vitit 1999, i nënshkruar më 21 qershor 1999;

f) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, bazuar në Marrëveshjet Ushtarake të Grandit, i nënshkruar më 21 qershor 1999;

g) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 29 mars 2000;

h) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 4 tetor 2000;

i) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë

së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 23 prill 2001;

j) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 20 qershor 2001;

k) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 1 prill 2002;

l) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 4 korrik 2002;

m) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë se Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 15 korrik 2003;

n) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 18 dhjetor 2003;

o) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 8 shtator 2004;

p) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 4 nëntor 2004;

r) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 5 shtator 2005;

s) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 30 shtator;

t) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 12 korrik 2006;

u) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 27 nëntor 2006;

v) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 9 tetor 2007;

y) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 14 dhjetor 2007;

z) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar më 1 dhjetor 2008;

aa) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 25 shkurt 2009;

bb) Marrëveshja Ushtarake e Grandit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, e nënshkruar më 3 dhjetor 2009;

cc) Protokolli i Zbatimit Logjistik ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 25 maj 2010.

Neni XI

Teksti dhe nënshkrimet

1. Kjo Marrëveshje përgatitet në dy kopje origjinale, në gjuhët turke, shqipe dhe angleze, ku secili tekst është njëlloj autentik. Në rast mosmarrëveshjeje që mund të lindë për shkak të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, mbizotëron teksti në anglisht.

2. Kjo Marrëveshje, në dëshmi të së cilës, të poshtëshënuarit janë përfaqësues të autorizuar rregullisht të të dyja Palëve, u nënshkrua më në Tiranë, më 24.1.2020, në Tiranë, më 24.2.2020, në Ankara.

NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË
NËNSHKRIMI:
EMRI: Hulusi AKAR
TITULLI: Ministër i Mbrojtjes Kombëtare

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NËNSHKRIMI:
Emri: Olta Xhaçka
TITULLI: Ministër i Mbrojtjes